5. Ngarkohen Drejtoria e Ligjore dhe Shwebimet Organizative dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik e Menaxhimit Financiar, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**JURIST**

**Julinda Karteri**

**KRYETAR**

**Arben Gumeni**

**Lidhja Nr. 1 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 5 001 - 20 000 banorë**

| Kategoria | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 1 | — | Administrator | — | 120,000 |
| 2 | IV-3 | Specialist | 1/2/3 | 60,000 |
| 3 | IV-4 | Specialist | 1/2/3 | 55,000 |
| | | | | |

**Lidhja Nr. 2 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me më pak se 5 000 banorë**

| Kategoria | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 1 | — | Administrator | — | 90,000 |
| 2 | IV-4 | Specialist | 1/2/3 | 55,000 |

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 1, llogaritet mbi shtesën e pozicionit, në masën si vijon:
   - 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
   - 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
   - 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

**Lidhja nr. 3 – Niveli i pagës për punonjësit administrativ të Njësive Administrative**

| Nr | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Paga bazë | Shtesa për vjetërsi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pika 11 | Punonjës administrative | 57,000 | 1% |
| 2 | | Punëtor Shërbimi, Mirëmbajtës | 50,000 | 1% |
| 6 | | Pastrues, Roje | 50,000 | 1% |

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr.2 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 738/4 prot. Tepelenë, më 22.04.2026

P/ **V E N D I M**

Nr. 27, datë 30.03.2026

**"PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE TEPELENË"**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 54 shkronja "ç", nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, nenit 9, të ligjit nr. 35, datë 25.05.2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, të ndryshuar si dhe në vijim të relacionit tw grupit tw punws nr.1 prot., datë.2026, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

**1.** Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Policisë Bashkiake, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
**2.** Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar të vitit 2026 dhe do të përballohen nga buxheti i miratuar i Aparatit të Bashkisë për vitin 2026.
3. Vendimi nr. 86, datë 30.11.2023 i ndryshuar me Vendimin nr 55, datw 30.09.2024 , i Këshillit Bashkiak "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë së Tepelenës", shfuqizohet.
4. Ngarkohen Drejtoria e Ligjore dhe Shwebimet Organizative dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik e Menaxhimit Financiar, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**JURIST**

**Julinda Karteri**

**K R Y E T A R**

**Arben Gumeni**

**Lidhja Nr.1**

**Niveli i pagave për punonjësit e Policisë Bashkiake**

| II | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Paga bazë | Shtesa për vjetërsi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Pika 10** | Inspektor i Policisë Bashkiake | 60,000 | 1% |
| 2 | **Pika 10** | Polic Bashkiak | 55,000 | 1% |

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 1, për kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

2. Shtesë për natyrë të veçantë pune për Lidhjen nr. 3, për kategorinë II, të jepet në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj.

Nr. 786. Prot                                                                                    Dt. 22.04.2026

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BASHKIA TEPELENE**
**DREJTORIA E ARSIM KULTURES DHE KUJDESIT SOCIAL**

# RELACION

## PËR DHENIE TITULL NDERI "QYTETAR NDERI"

Te nderuar këshilltarë ,

Pranë Drejtorisë së Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social është paraqitur kërkesa për dhënie titull nderi 'Qyetar Nderi"

Nr 116 prot date 20.04.2026 te Njesise Administrative Qender Tepelene "Per dhenie Titull Nderi Sulejman Liçaj (Pas vdekjes)

Nr 606 prot date 20.03.2026 te Shoqates Kulturore Atdhetare Laberia Per dhenie titull nderi z. Ardian Hana (Pas vdekjes)

Ky propozim është deleguar tek Kryetari i Bashkisë i cili ka propozuar pranë Komisionit Këshillimor të Bashkisë Tepelenë për qytetarët .

Materiali plotëson kriteret për t'ju propozuar juve si Këshill Bashkiak për miratim për shpallje Qytetar Nderi.

Bashkelidhur ju veme ne dispozicion :

Projekt Vendimi

Propozimi i Kryetarit

Relacioni i Komisionit Keshillimor

Ju faleminderit.

**DREJTORI**

**Arta Shaha**

Nr. 786/1. Prot

Dt. 22.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI BASHKIAK
TEPELENE

**PROJEKT VENDIM**

**NR_____ DATE _____/____/ 2026**

**PER DHENIE TITULL NDERI**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës ___/___/2025 , në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 54 pika "m" ; Ligjit 112/2013 "Për dekoratat , titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit të RSH" pasi shqyrtoi materialin e Komisionit Këshillimor të Bashkisë Tepelene

**V E N D O S I**

A. Të miratojë dhënien e titujve të nderit si më poshtë:

- ***Z. Sulejman Liçaj*** propozuar nga Kryetari i Bashkisë për dhënie titull nderi "Qytetar Nderi" (Pas vdekjes) me motivacionin "*Për kontributin e çmuar në hedhjen e themeleve të shkollës kombëtare shqiptare të muzikës profesioniste përmes përfshirjes në lëvizjen kulturore dhe artistike në përgjithësi, dhe asaj bandistike në veçanti, në qytetin e Shkodrës e në mbarë trevat shqiptare*".
- **Z. Ardian Hana** propozuar nga Kryetari i Bashkise per dhenie titull nderi " Qytetar Nderi" (Pas vdekjes) me motivacionin : "*Për sakrificën në krye të detyrës, përkushtimin e palëkundur ndaj shtetit dhe shoqërisë, si dhe për guximin, ndershmërinë dhe dashurinë për atdheun* ".

B. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social.

C. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**JURIST**

**Julinda Karteri**

**KRYETARI**

**Arben GUMENI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENË

PROPOZIM I KRYETARIT

Komisionit Këshillimor të Bashkisë Tepelenë

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 54 pika "m" ; të ligjit 112/2013 "Për dekoratat , titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor të nderit në RSH", VKM Nr 861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në RSH" me qëllim nderimin e figurave që kanë kontribuar për qytetin tonë por dhe më gjerë pranë Bashkisë Tepelenë janë paraqitur propozime nga shoqata të ndryshme.

Duke vlerësuar kontributin e tyre në fusha të ndryshme Kryetari i Bashkisë ju parashtron për vlerësim propozimin për dhënie tituj nderi, Komisionit Këshillimor në nderim të figurave që promovojnë vlerat në interes të komunitetit.

- ***Z. Sulejman Liçaj*** propozuar nga Kryetari i Bashkisë për dhënie titull nderi "Qytetar Nderi" (Pas vdekjes) me motivacionin "*Për kontributin e çmuar në hedhjen e themeleve të shkollës kombëtare shqiptare të muzikës profesioniste përmes përfshirjes në lëvizjen kulturore dhe artistike në përgjithësi, dhe asaj bandistike në veçanti, në qytetin e Shkodrës e në mbarë trevat shqiptare.*

*Jeta dhe veprimtaria*

Sulejman Liçaj u lind në Luzat të Tepelenës në vitin 1892. Kur ishte ende i mitur familja e tij mërgoi në Turqi. Aty ai u arsimua në kolegjin ushtarak të Stambollit për muzikës. Falë talentit Sulejmani ra në sy jo vetëm si instrumentisti spikatur por edhe si njohës i teorisë së muzikës. Ai zotëronte mjeshtërisht instrumentet frymorë, si Flikornot e Klarinetat që janë pjesë e pandashme e Bandave Frymore apo Fanfarave Frymore Ushtarake. Gjithashtu, mori mësime në violinë e mandolinë. Menjëherë pas përfundimit të studimeve ra në kontakt me Shoqatën Vatra në Amerikë, të cilët i sugjeruan të kthehej në Shqipëri për të ndihmuar në ngritjen e formacioneve të para muzikore shqiptare. Mjeshtri Liçaj u lidh me atdhetarin Hilë Mosi, i cili e dërgoi në qytetin e Shkodrës, qytetin ku kish lindur e para bandë muzikore në Shqipëri dhe ku po lulëzonte një lëvizje artistike e jashtëzakonshme. AtyMjeshtri Liçaj u lidh me muzikantin Pavllo Zhvap, qësollinë vitin 1922 edhe krijimin "Orkestrën Frymore të Garnizonit Ushtarak" të Shkodrës, të cilin Mjeshtri edhe e drejtoi. Banda shoqëronte parada, por merrte pjesë edhe në festat e ndryshme. Në vitin 1930, me ndihmën e qytetarëve shkodranë, si dhe të mësuesve si Ragip Gjylbegu, Shefqet Muka, Mehmet Gjyli etj., ngriti dhe formoi "Bandën Muzikore të Shkollës Plotore" të Parrucës. Banda, si fillim, numëronte në radhët e saj rreth 15 instrumentistë të rinj - midis tyre edhe flautistin, kompozitorin dhe studjuesin e ardhshëm Ramadan Sokoli - por me kohë ajo u zgjerua duke arritur në mbi 50 instrumentistë. Repertori i saj ishte i ngjashëm me atë të orkestrave të tjera frymore.Sipas Saraçit, "Repertori i tyre vinte githmonë duke u

zgjeruar dhe krahas këngëve korale fetare e qytetare, këngëve atdhetare e popullore të përshtatura për orkestër frymore, ekzekutoheshin edhe mjaft pjesë të zgjedhura nga literatura përkatëse, që gjallëronte mjaft jetën e qytetit ndër festa".

Veshjet karakeristike të trevave jugore të Shqipërisë – për këte arsye quhej ndryshe dhe "Banda e Fustanellave", fakt sa i veçantë aq edhe domethënës në kuadrin e unitetit kombëtar -, që karakterizonin në mënyrë të veçantë këtë bandë frymore e perkusive, tregon dinjitet dhe frymëzonin e përhapnin nëpër qytet patriotizëm, unitet kombëtar dhe atdhedashuri, sidomos tek të rinjtë. Ja cfarë shkruhet në historikun e ish-shkollës Plotore: "Në vitin shkollor 1930-1931, edhe me mbështetjen e mësuesve të shkollës së Parrucës, u krijua banda e parë muzikore e shkollave fillore laike në Shqipëri. Nxënësit kishin një kostum zyrtar dhe një kombëtar (fustanellat sh.a). Kjo orkestër frymore ka dhënë shfaqje në ditët e festave kombëtare dhe fetare në Shkodër, Tiranë, Ulqin e Podgoricë ...." e më tej dëshmohet: "Për më tepër patën guximin të zhvillonin një aktivitet në Ulqin, që pati një jehonë të madhe". Ky koncert bëri efektin e një bombe…"; komenti i një gazete të Podgoricës" Kaq jehonë bëri kjo bandë muzikore në mbarë qytetin e Shkodrës dhe kaq shumë ndikoi ajo në jetën e saj kulturore, sa nën shëmbullin e shkollës së "Parrucës"në vitin 1931 u formua Fanfara e Konviktit "Malet Tona" nën drejtimin e Mjeshtrit Zef Kurti (djalit të Palok Kurtit - shënim i studiuesit).

Pas qytetit të Shkodrës, dhe nën ndikimin mjaft pozitiv që pati banda muzikore ushtarake e garnizonit të Shkodrës, Mjeshtri Sul Liçaj ftohet të ngrejë e të formojë Bandën Muzikore të Garnizonit Ushtarak të rajonit Durrës-Kavajë e pas saj "Bandën Muzikore të Regjimentit të Ushtrisë" që ndodhej pranë qytetit të Elbasanit, detyra, të cilat ai i kryen më së miri e me sukses të plotë dhe përkushtueshmëri e profesionalitet të lartë, duke zgjeruar ndjeshëm veprimtaritë muzikore dhe artistike në qytetet e përmëndura më sipër.

Me përkushtim akoma edhe më të madh Mjeshtri Liçaj, aty rreth mesit të viteve 30' rikthehet nëveri të Shqipërisë, por këtëhere në zonën e Drinabardhës (Kukës – Gjakovë), ku bëhet bashkënismëtar në formimin e bandës muzikore "Kosova" me qendër në Kukës por me shtrirje veprimtarie në mbarëKosovën e Shqipërinë. Për veprimtarinë e tij, ndikimin patriotik sidomos tek të rinjtë dhe profesionalizmin e lartë që mëshironte si muzikant tejet i kompletuar u thirr të jepte kontributin e tij pranë trupës së njohur të "Bandës Muzikore Mbretërore" deri në pushtimin e vëndit, ku megjithëse ky entitet nën emrin "Banda Muzikore Perandorake" vazhdoi të ekzistonte e të koncertonte madje edhe jashtë vendit, ai dha dorëheqjen në shenjë proteste ndaj pushtimit fashist dhe u tërhoq në qytetin bujar dhe mikpritës të Shkodrës. Me riformimin e "Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura", së bashku me Mjeshtrat Gaqo Avrazi, Kristaq Panduku etj., kontributi i tij i vyer shërbeu edhe në ngritjen dhe formimin e bandave dhe fanfareve muzikore. Ai u thirr në Tiranë të ndihmonte për rimëkëmbjen e këtij entiteti, ku edhe përfundoi e mbylli karrierën e tij të pasur artistike e patriotike si personazh i rëndësishëm për lëvizjen kulturore dhe artistike në përgjithësi, dhe asaj bandistike në veçanti, në qytetin e Shkodrës e më tej ndër treva shqiptare, njëri nga personalitetet e spikatura të asaj që do të quhej e konsiderohej me të drejtë si: "thysat apo filizat" e para, "fillesat" e asaj "nga ku buroi", të asaj "nga ku nisi rrugëtimi", apo "nga ku u hoqën konturet e para dalluese", të shkollës kombëtare shqiptare të muzikës profesioniste, duke rezultuar kështu përcaktues në pasqyrimin e vlerave më të larta morale e kulturore të popullit shqiptar: si në aspektin e forcimit të ndjenjes së atdhedashurisë ashtu edhe për rritjen e koshiencës kolektive ndaj virtyteve dhe vlerave të paçmuara kombëtare, e për rrjedhojë, bashkëpromotorë të rizgjimit apo rilindjes së kombit shqiptar.

- **Ardian Hana** propozuar nga Kryetari i Bashkise per dhenie titull nderi „Qytetar Nderi" (Pas vdekjes) me motivacionin : " *Për sakrificën në krye të detyrës, përkushtimin e palëkundur ndaj shtetit dhe shoqërisë, si dhe për guximin, ndershmërinë dhe dashurinë për atdheun* ".

*Jeta dhe veprimtaria*

**Ardian Hana** lindi më **22 gusht 1975** në fshatin **Dhëmblan, Tepelenë**, në një familje të thjeshtë, por me vlera të larta njerëzore dhe dinjitet. Ishte djali i prindërve **Jonuzi dhe Xhevairja Hana**, të cilët me përkushtim dhe sakrificë edukuan dhe arsimuan shtatë fëmijët e tyre.

Ardiani kreu arsimin fillor dhe 8-vjeçar në fshatin e lindjes, Dhëmblan, ndërsa arsimin e mesëm e përfundoi në **Sinanaj** në vitin **1995**. Në vitin **1996** kreu shërbimin ushtarak në **Libohovë, Gjirokastër**.

Pas përfundimit të shërbimit ushtarak, ai nisi punë në **Policinë e Shtetit**, pranë Komisariatit të Policisë Tepelenë, ku shërbeu për **4 vite** me përkushtim dhe ndershmëri.

Në **shtator të vitit 2002**, Ardiani krijoi familjen e tij duke u martuar me bashkëshorten **Migena**, me të cilën u bekua me tre fëmijë: një vajzë dhe dy djem. Fatkeqësisht, vajza ndërroi jetë vetëm 6 muajshe. Dy djemtë e tij sot jetojnë dhe janë integruar në shoqëri në emigrim, në **Angli**.

Në vitin **2004**, ai nisi shërbimin në Ushtri, depon ushtarake në fshatin Dhëmblan ky repart varej nga Berati, duke vijuar rrugën e tij në shërbim të vendit.

Më **6 maj 2006**, gjatë kryerjes së detyrës ushtarake, Ardian Hana u plagos rëndë në një ngjarje tragjike, duke dëshmuar guxim dhe përkushtim të jashtëzakonshëm. Edhe në momentet më të vështira, ai nuk u tërhoq nga detyra, duke vendosur mbi gjithçka përgjegjësinë ndaj jetës së të tjerëve dhe ndaj atdheut.

Pas një përpjekjeje **21-ditore** mes jetës dhe vdekjes, ai ndërroi jetë në spitalet e **Italisë**, duke u shpallur **i rënë në krye të detyrës.**

**Vlerat dhe figura e tij**

Ardian Hana ishte djali më i vogël i një familjeje të madhe me **5 vëllezër dhe 2 motra**. Ai u rrit mes sakrificave, por gjithmonë me ndjenjën e fortë të përgjegjësisë, punës dhe ndershmërisë.

Njihej si:

- njeri i dashur dhe i respektuar nga të gjithë,
- punëtor dhe i përkushtuar në çdo detyrë,
- shembull i korrektësisë dhe integritetit.

Ai ishte një **bir i denjë i krahinës së Lopësit**, i rritur me frymë atdhedashurie dhe me traditë familjare të lidhur ngushtë me shërbimin ndaj vendit.

Familja Hana përfaqëson një trashëgimi të gjatë kontributi dhe sakrifice për atdheun, që nga **Lufta Antifashiste** e deri në ditët e sotme.

**Trashëgimia**

Figura e Ardian Hanës mbetet një simbol i:

- sakrificës në krye të detyrës,
- përkushtimit ndaj shtetit dhe shoqërisë,

- guximit dhe ndershmërisë,
- dashurisë për atdheun.

Ai la pas një trashëgimi të çmuar për familjen, komunitetin dhe gjithë zonën e Tepelenës.

**Përmbyllje**

Ardian Hana ra në krye të detyrës, por vepra dhe kujtimi i tij jetojnë përjetë në zemrat e familjes, të bashkëfshatarëve të Dhëmblanit, të Tepelenës dhe të gjithë atyre që e njohën.

Duke vlerësuar kontributin e dhënë për komunitetin personave të sipërpërmendur ju ftojmë të miratoni dhënien e titujve të nderit.

**KRYETARI I BASHKISE**

**Gramos SAKO**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENË
KOMISIONI KESHILLIMOR I VLERESIMIT TE FIGURAVE DHE TITUJVE TE NDERIT

## RELACION

Komisioni Këshillimor i Bashkisë Tepelenë pasi verifikoi projekt propozimin e Kryetarit të Bashkisë lidhur me kërkesat e ardhura pranë Bashkisë për vlerësim të figurave me kontribut në fusha të ndryshme , propozon që këto kërkesa të kalojnë për miratim në Këshillin Bashkiak.

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 54 pika "m" ; të ligjit 112/2013 "Për dekoratat , titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor të nderit në RSH", VKM Nr 861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në RSH" me qëllim nderimin e figurave që kanë kontribuar për qytetin tonë por dhe më gjerë pranë Bashkisë Tepelenë janë paraqitur propozime nga shoqata të ndryshme.

Duke vlerësuar kontributin e tyre në fusha të ndryshme Kryetari i Bashkisë ju parashtron për vlerësim propozimin për dhënie tituj nderi, Komisionit Këshillimor në nderim të figurave që promovojnë vlerat në interes të komunitetit.

- ***Z. Sulejman Liçaj*** propozuar nga Kryetari i Bashkisë për dhënie titull nderi "Qytetar Nderi" (Pas vdekjes) me motivacionin *"Për kontributin e çmuar në hedhjen e themeleve të shkollës kombëtare shqiptare të muzikës profesioniste përmes përfshirjes në lëvizjen kulturore dhe artistike në përgjithësi, dhe asaj bandistike në veçanti, në qytetin e Shkodrës e në mbarë trevat shqiptare.*

*Jeta dhe veprimtaria*

Sulejman Liçaj u lind në Luzat të Tepelenës në vitin 1892. Kur ishte ende i mitur familja e tij mërgoi në Turqi. Aty ai u arsimua në kolegjin ushtarak të Stambollit për muzikës. Falë talentit Sulejmani ra në sy jo vetëm si instrumentisti spikatur por edhe si njohës i teorisë së muzikës. Ai zotëronte mjeshtërisht instrumentet frymorë, si Flikornot e Klarinetat që janë pjesë e pandashme e Bandave Frymore apo Fanfarave Frymore Ushtarake. Gjithashtu, mori mësime në violinë e mandolinë. Menjëherë pas përfundimit të studimeve ra në kontakt me Shoqatën Vatra në Amerikë, të cilët i sugjeruan të kthehej në Shqipëri për të ndihmuar në ngritjen e formacioneve të para muzikore shqiptare. Mjeshtri Liçaj u lidh me atdhetarin Hilë Mosi, i cili e dërgoi në qytetin e Shkodrës, qytetin ku kish lindur e para bandë muzikore në Shqipëri dhe ku po lulëzonte një lëvizje artistike e jashtëzakonshme. AtyMjeshtri Liçaj u lidh me muzikantin Pavllo Zhvap, qësollinë vitin 1922 edhe krijimin "Orkestrën Frymore të Garnizonit Ushtarak" të Shkodrës, të cilin Mjeshtri edhe e drejtoi. Banda shoqëronte parada, por merrte pjesë edhe në festat e ndryshme. Në vitin 1930, me ndihmën e qytetarëve shkodranë, si dhe të mësuesve si Ragip Gjylbegu, Shefqet Muka, Mehmet Gjyli etj., ngriti dhe formoi "Bandën Muzikore të Shkollës Plotore" të Parrucës. Banda, si fillim, numëronte në radhët e saj rreth 15 instrumentistë të rinj - midis tyre edhe flautistin, kompozitorin dhe studjuesin e ardhshëm Ramadan Sokoli - por me kohë ajo u zgjerua duke arritur në mbi 50 instrumentistë. Repertori i saj ishte i

ngjashëm me atë të orkestrave të tjera frymore.Sipas Saraçit, "Repertori i tyre vinte githmonë duke u zgjeruar dhe krahas këngëve korale fetare e qytetare, këngëve atdhetare e popullore të përshtatura për orkestër frymore, ekzekutoheshin edhe mjaft pjesë të zgjedhura nga literatura përkatëse, që gjallëronte mjaft jetën e qytetit ndër festa".

Veshjet karakeristike të trevave jugore të Shqipërisë – për këte arsye quhej ndryshe dhe "Banda e Fustanellave", fakt sa i veçantë aq edhe domethënës në kuadrin e unitetit kombëtar -, që karakterizonin në mënyrë të veçantë këtë bandë frymore e perkusive, tregon dinjitet dhe frymëzonin e përhapnin nëpër qytet patriotizëm, unitet kombëtar dhe atdhedashuri, sidomos tek të rinjtë. Ja cfarë shkruhet në historikun e ish-shkollës Plotore: "Në vitin shkollor 1930-1931, edhe me mbështetjen e mësuesve të shkollës së Parrucës, u krijua banda e parë muzikore e shkollave fillore laike në Shqipëri. Nxënësit kishin një kostum zyrtar dhe një kombëtar (fustanellat sh.a). Kjo orkestër frymore ka dhënë shfaqje në ditët e festave kombëtare dhe fetare në Shkodër, Tiranë, Ulqin e Podgoricë ...." e më tej dëshmohet: "Për më tepër patën guximin të zhvillonin një aktivitet në Ulqin, që pati një jehonë të madhe". Ky koncert bëri efektin e një bombe…"; komenti i një gazete të Podgoricës" Kaq jehonë bëri kjo bandë muzikore në mbarë qytetin e Shkodrës dhe kaq shumë ndikoi ajo në jetën e saj kulturore, sa nën shëmbullin e shkollës së "Parrucës"në vitin 1931 u formua Fanfara e Konviktit "Malet Tona" nën drejtimin e Mjeshtrit Zef Kurti (djalit të Palok Kurtit - shënim i studiuesit).

Pas qytetit të Shkodrës, dhe nën ndikimin mjaft pozitiv që pati banda muzikore ushtarake e garnizonit të Shkodrës, Mjeshtri Sul Liçaj ftohet të ngrejë e të formojë Bandën Muzikore të Garnizonit Ushtarak të rajonit Durrës-Kavajë e pas saj "Bandën Muzikore të Regjimentit të Ushtrisë" që ndodhej pranë qytetit të Elbasanit, detyra, të cilat ai i kryen më së miri e me sukses të plotë dhe përkushtueshmëri e profesionalitet të lartë, duke zgjeruar ndjeshëm veprimtaritë muzikore dhe artistike në qytetet e përmëndura më sipër.

Me përkushtim akoma edhe më të madh Mjeshtri Liçaj, aty rreth mesit të viteve 30' rikthehet nëveri të Shqipërisë, por këtëhere në zonën e Drinabardhës (Kukës – Gjakovë), ku bëhet bashkënismëtar në formimin e bandës muzikore "Kosova" me qendër në Kukës por me shtrirje veprimtarie në mbarëKosovën e Shqipërinë. Për veprimtarinë e tij, ndikimin patriotik sidomos tek të rinjtë dhe profesionalizmin e lartë që mëshironte si muzikant tejet i kompletuar u thirr të jepte kontributin e tij pranë trupës së njohur të "Bandës Muzikore Mbretërore" deri në pushtimin e vëndit, ku megjithëse ky entitet nën emrin "Banda Muzikore Perandorake" vazhdoi të ekzistonte e të koncertonte madje edhe jashtë vendit, ai dha dorëheqjen në shenjë proteste ndaj pushtimit fashist dhe u tërhoq në qytetin bujar dhe mikpritës të Shkodrës. Me riformimin e "Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura", së bashku me Mjeshtrat Gaqo Avrazi, Kristaq Panduku etj., kontributi i tij i vyer shërbeu edhe në ngritjen dhe formimin e bandave dhe fanfareve muzikore. Ai u thirr në Tiranë të ndihmonte për rimëkëmbjen e këtij entiteti, ku edhe përfundoi e mbylli karrierën e tij të pasur artistike e patriotike si personazh i rëndësishëm për lëvizjen kulturore dhe artistike në përgjithësi, dhe asaj bandistike në veçanti, në qytetin e Shkodrës e më tej ndër treva shqiptare, njëri nga personalitetet e spikatura të asaj që do të quhej e konsiderohej me të drejtë si: "thysat apo filizat" e para, "fillesat" e asaj "nga ku buroi", të asaj "nga ku nisi rrugëtimi", apo "nga ku u hoqën konturet e para dalluese", të shkollës kombëtare shqiptare të muzikës profesioniste, duke rezultuar kështu përcaktues në pasqyrimin e vlerave më të larta morale e kulturore të popullit shqiptar: si në aspektin e forcimit të ndjenjes së atdhedashurisë ashtu edhe për rritjen e koshiencës kolektive ndaj virtyteve dhe vlerave të paçmuara kombëtare, e për rrjedhojë, bashkëpromotorë të rizgjimit apo rilindjes së kombit shqiptar.

- **Ardian Hana** propozuar nga Kryetari i Bashkise per dhenie titull nderi „Qytetar Nderi" (Pas vdekjes) me motivacionin *:" Për sakrificën në krye të detyrës, përkushtimin e palëkundur ndaj shtetit dhe shoqërisë, si dhe për guximin, ndershmërinë dhe dashurinë për atdheun ".*

*Jeta dhe veprimtaria*

**Ardian Hana** lindi më **22 gusht 1975** në fshatin **Dhëmblan, Tepelenë**, në një familje të thjeshtë, por me vlera të larta njerëzore dhe dinjitet. Ishte djali i prindërve **Jonuzi dhe Xhevairja Hana**, të cilët me përkushtim dhe sakrificë edukuan dhe arsimuan shtatë fëmijët e tyre.

Ardiani kreu arsimin fillor dhe 8-vjeçar në fshatin e lindjes, Dhëmblan, ndërsa arsimin e mesëm e përfundoi në **Sinanaj** në vitin **1995**. Në vitin **1996** kreu shërbimin ushtarak në **Libohovë, Gjirokastër**.

Pas përfundimit të shërbimit ushtarak, ai nisi punë në **Policinë e Shtetit**, pranë Komisariatit të Policisë Tepelenë, ku shërbeu për **4 vite** me përkushtim dhe ndershmëri.

Në **shtator të vitit 2002**, Ardiani krijoi familjen e tij duke u martuar me bashkëshorten **Migena**, me të cilën u bekua me tre fëmijë: një vajzë dhe dy djem. Fatkeqësisht, vajza ndërroi jetë vetëm 6 muajshe. Dy djemtë e tij sot jetojnë dhe janë integruar në shoqëri në emigrim, në **Angli**.

Në vitin **2004**, ai nisi shërbimin në Ushtri, depon ushtarake në fshatin Dhëmblan ky repart varej nga Berati, duke vijuar rrugën e tij në shërbim të vendit.

Më **6 maj 2006**, gjatë kryerjes së detyrës ushtarake, Ardian Hana u plagos rëndë në një ngjarje tragjike, duke dëshmuar guxim dhe përkushtim të jashtëzakonshëm. Edhe në momentet më të vështira, ai nuk u tërhoq nga detyra, duke vendosur mbi gjithçka përgjegjësinë ndaj jetës së të tjerëve dhe ndaj atdheut.

Pas një përpjekjeje **21-ditore** mes jetës dhe vdekjes, ai ndërroi jetë në spitalet e **Italisë**, duke u shpallur **i rënë në krye të detyrës**.

**Vlerat dhe figura e tij**

Ardian Hana ishte djali më i vogël i një familjeje të madhe me **5 vëllezër dhe 2 motra**. Ai u rrit mes sakrificave, por gjithmonë me ndjenjën e fortë të përgjegjësisë, punës dhe ndershmërisë.

Njihej si:

- njeri i dashur dhe i respektuar nga të gjithë,
- punëtor dhe i përkushtuar në çdo detyrë,
- shembull i korrektësisë dhe integritetit.

Ai ishte një **bir i denjë i krahinës së Lopësit**, i rritur me frymë atdhedashurie dhe me traditë familjare të lidhur ngushtë me shërbimin ndaj vendit.

Familja Hana përfaqëson një trashëgimi të gjatë kontributi dhe sakrifice për atdheun, që nga **Lufta Antifashiste** e deri në ditët e sotme.

**Trashëgimia**

Figura e Ardian Hanës mbetet një simbol i:

- sakrificës në krye të detyrës,
- përkushtimit ndaj shtetit dhe shoqërisë,
- guximit dhe ndershmërisë,
- dashurisë për atdheun.

Ai la pas një trashëgimi të çmuar për familjen, komunitetin dhe gjithë zonën e Tepelenës.

**Përmbyllje**

Ardian Hana ra në krye të detyrës, por vepra dhe kujtimi i tij jetojnë përjetë në zemrat e familjes, të bashkëfshatarëve të Dhëmblanit, të Tepelenës dhe të gjithë atyre që e njohën.

Duke vlerësuar kontributin e dhënë për komunitetin personave të sipërpërmendur ju ftojmë të miratoni dhënien e titujve të nderit.

**KRYETARI**

**KOMISIONIT KËSHILLIMOR**

**Spiro Kora**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË**

**DREJTORIA E ARSIM KULTURES DHE KUJDESIT SOCIAL**

Nr. 798 prot. Tepelenë, më 23 .04.2026

**RELACION**

**PËR EMËRTIM RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE LOPES ,**

**BASHKIA TEPELENË**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", pranë Drejtorisë së Arsim kulturës dhe Kujdesit social është paraqitur me shkresë nr 754 prot , date 20.04.2026 , Njesia Administrative Lopes Tepelene , kërkesë për emërtim rruge në Njesine Administrative Lopes , *Segmenti i rruges nga Sinanaj ne Matohasanaj me gjatesi 2.38 km të marrë emrin "Naim Muhaj"*

Jeta dhe veprimtaria

Lindi në fshatin Matohasanaj të Tepelenës te krahines se Lopesit, ku dhe kaloi vitet e femijerise dhe kreu shkollen fillore. Me perfundimin e studimeve te larta ne Shkollen e Bashkuar te Oficerave, emerohet ne ishullin e Sazanit.

Ne fund te viteve 70' u emerua Komandant i Korpusit te Tiranes, me vone Komandant i Divizionit te Lushnjes.

Ne mesin e viteve 80' u denua si" sabotator "i ishullit te Sazanit ne nje kohe qe per fortifikimin e ishullit kishte marre vleresime nga Autoritetet me te larta te kohes.

Fitoi pafajesine ne vitet e par ate demokracise dhe rikthehet ne Ministrine e Mbrojtjes me graden Kolonel/Perkushtimi dhe kontributet e tij jane te medha edhe ne periudhen Post-komuniste, ne reformimin e ushtrise per permbushjen e misionit.KA dhene contribute te medha ne krijimin e shoqerise Atdhetare "Sazani" dhe ne organizimin dhe drejtimin e shoqates Aleanca e Ushtarakeve te Shqiperise.

Naimi ka mbartur virtyte, vlera humane dhe contribute te veçanta.Per kontributet sin je kuader I devotshem , nje familjar shembullor dhe demokraci te vertete, ka marre titullin "Qytetar Nderi" dhe "Mirenjohja e Qytetit" , respektivisht nga Bashkia Tepelene dhe Vlore.

Nisur nga sa më sipër kërkojmë miratimin e Këshillit Bashkiak për propozimin e bërë nga Kryetari i Bashkise Tepelenë.

**DREJTORI**

**Arta Shaha**

*Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë* *Web: www.tepelena.gov.al* *E-mail: info@tepelena.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENEË**

**KRYETARI**

## PËR EMËRTIM RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE LOPES, BASHKIA TEPELENË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", pranë Drejtorisë së Arsim kulturës dhe Kujdesit social është paraqitur me shkresë nr 754 prot , date 20.04.2026 , Njesia Administrative Lopes Tepelene , kërkesë për emërtim rruge në Njesine Administrative Lopes , *Segmenti i rruges nga Sinanaj ne Matohasanaj me gjatesi 2.38 km të marrë emrin "Naim Muhaj"*

Jeta dhe veprimtaria

Lindi në fshatin Matohasanaj të Tepelenës te krahines se Lopesit, ku dhe kaloi vitet e femijerise dhe kreu shkollen fillore. Me perfundimin e studimeve te larta ne Shkollen e Bashkuar te Oficerave, emerohet ne ishullin e Sazanit.

Ne fund te viteve 70' u emerua Komandant i Korpusit te Tiranes, me vone Komandant i Divizionit te Lushnjes.

Ne mesin e viteve 80' u denua si" sabotator "i ishullit te Sazanit ne nje kohe qe per fortifikimin e ishullit kishte marre vleresime nga Autoritetet me te larta te kohes.

Fitoi pafajesine ne vitet e par ate demokracise dhe rikthehet ne Ministrine e Mbrojtjes me graden Kolonel/Perkushtimi dhe kontributet e tij jane te medha edhe ne periudhen Post-komuniste, ne reformimin e ushtrise per permbushjen e misionit.KA dhene contribute te medha ne krijimin e shoqerise Atdhetare "Sazani" dhe ne organizimin dhe drejtimin e shoqates Aleanca e Ushtarakeve te Shqiperise.

Naimi ka mbartur virtyte , vlera humane dhe contribute te veçanta.Per kontributet sin je kuader I devotshem , nje familjar shembullor dhe demokraci te vertete, ka marre titullin "Qytetar Nderi" dhe "Mirenjohja e Qytetit" , respektivisht nga Bashkia Tepelene dhe Vlore.

Nisur nga sa më sipër kërkojmë miratimin e Këshillit Bashkiak për propozimin e bërë nga Njësia Administrative Lopes Tepelenë.

**KRYETARI**

**Gramos SAKO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË**

**KËSHILLI**

Nr 798/1 Prot

Tepelene me 23 /04 /2026

**PROJEKT/ VENDIM**

Nr. ________ datë__________2026

## PËR EMËRTIM RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE LOPES, BASHKIA TEPELENË

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____ ________ me propozim të Kryetarit të Bashkisë , mbështetur në nenin 9 pika 1,nënpika 1.1 shkronjat "a"dhe "b", të nenit 23 , të nenit 54 shkronja"ll", dhe nenit 55 të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", relacionit te Drejtorisë së Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social

**VENDOSI**

1- Miratimin e emërtimit me emrin "Naim Muhaj " të rrugës sipas fragmentimit të hartës bashkëngjitur , në njësinë Administrative Lopes Tepelenë si më poshtë :

*Segmenti i rruges nga Sinanaj ne Matohasanaj me gjatesi 2.38 km të marrë emrin "Naim Muhaj"*

2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social si dhe Njësia Administrative Lopes Tepelenë.

3- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore."

**JURIST**

**Julinda Karteri**

**KRYETARI**

**Arben GUMENI**

# PLAN - VENDOSJA E RRUGES "NAIM MUHAJ"

**PRONARI: SHTET** **DATE** 24.04.2026 QËLLIMI : PER EMERTIM RRUGE

**VENDNDODHJA:**

BASHKIA TEPELENE DVASHK:GJIROKASTER ZONA KADASTRALE:2613+3452 NUMURI PASURIE INDEKS HARTE:K-34-124- (235-B+D)

**TE DHENAT E PASURISE**

LLOJI I PASURISE : RRUGE SIP.PASURISE = 2.38 Km SIP. GJURMES NDERTIMIT = $m^2$ NR. KATEVE 1(NJE) NR.PEMEVE

X,Y **KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE** X,Y




X,Y **SHK. 1:10000** X,Y

**REALIZOI PER BASHKINE TEPELENE**

EMRI: MAKSIM SHEHU

LICENCA NR. T0025/3

Data: 21.06.2017

NENESHKRIMI

KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREJTORI

NENESHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE : Z- Zyre, T-Terren

PERCAKTIMI I KUFIRIT : HK- Harta Kadastrale

SHENIME TE VECANTA:

**NJ.A.LOPËS PROPOZON EMERTIMIN E RRUGES NGA SINANAJ NE MATOHASANAJ ME GJATESI 2.38 KM ME EMRIN E NAIM MUHAJ SIPAS SHKRESES NR.754 PROT , DATE 20.04.2026.**

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIMI MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI : BASHKIA TEPELENE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË**

Nr.~~~~ prot. Tepelenë, më 22 .04.2026

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Z. Arben Gumeni**

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË**

**I nderuar,**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:
**"Për miratim të kërkesës, për heqje dore nga pasuria e paluajtshme me status juridik "Në përdorim të Bashkisë Tepelenë" me numër pasurie 3/1-A ZK3574 dhe numër rendor të pronës në listën e inventarit 1358 sipas VKM nr 6 datë 06.01.2011 "Për miratim të listës përfunimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë" fusha e përdorimit Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)**".

Me respekt,

**KRYETARI I BASHKISË**
Gramos Sako

**Miratoi:**

Inxh. Gëzim Shehu: Drejtor i Zhvillimit Rural

______________________: Drejtor i Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

______________________: Drejtor, Drejtoria Juridike

______________________: Përgjegjës i __________

**Konceptoi:**
DZHR

Datë: ___.04.2026

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 21

Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë wweb: www.tepelena.gov.al E-mail: info@tepelena.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA TEPELENË**
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL**

Nr. 788 Prot.

Tepelenë më 22 .04 2026

# RELACION

**"Për miratim të kërkesës, për heqje dore nga pasuria e paluajtshme me status juridik "Në përdorim të Bashkisë Tepelenë" me numër pasurie 3/1-A ZK3574 dhe nr rendor të pronës në listën e inventarit 1358 sipas VKM nr 6 datw 06.01.2011 "Për miratim të listës përfunimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë" fusha e përdorimit Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)"**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Tepelenë.

Në mbështetje të nenit 8 "Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor" dhe të nenit 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë"; ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 54, ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative"; neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", neni 3 i ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara"; Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit", Udhëzimin nr.3 datë 18.07.2002 "Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësite e Qeverisjes Vendore" dhe VKM nr.500 datë 14.08.2001 "Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore"; Kërkesave numër protokolli 341 datë 13.02.2026 dhe numër 341/2 datë 24.03.2026 të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SH.A (OSSH) për "Kërkesë për vendimmarrje të Këshillit Bashkiak Tepelenë" për heqjen e të drejtës së përdorimit të Bashkisë Tepelenë të një pjese të pasurisë nr.3/1 ZK3574 me qëllim lënien në dispozicion për vazhdimin e procedurës nga OSSH për kalimin në administrim të OSSH në funksion të nënstacionit elektrik 110/10 kV Tepelenë.

**PROPOZOJMË:**

1. Miratimin e fillimit të procedurës për të kërkuar nga Këshilli i Ministrave një ndryshim të VKM nr 6 datë 06.01.2011 "Për miratim të listës përfunimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë" për sipërfaqen me numër pasurie 3/1-A prej 925 $m^2$ nga pasuria numër 3/1 ZK3574 sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim lënien në dispozicion për vazhdimin e procedurës për kalimin në administrim të OSSH në funksion të nënstacionit elektrik 110/10 kV Tepelenë.

Grupi i Punës:

1. Maksim Shehu
2. Gëzim Shehu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
TEPELENË

Nr.788/1 prot. Tepelenë më 22.04. 2026

**P/V E N D I M**

**Nr.____. Datë.___.___.2026**

**"Për miratim të kërkesës, për heqje dore nga pasuria e paluajtshme me status juridik "Në përdorim të Bashkisë Tepelenë" me numër pasurie 3/1-A ZK3574 dhe numër rendor të pronës në listën e inventarit 1358 sipas VKM nr 6 datë 06.01.2011 "Për miratim të listës përfunimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë" fusha e përdorimit Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)"**.

Në mbështetje të nenit 8 "Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor" dhe të nenit 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë"; ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 54, ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative"; neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", neni 3 i ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara"; Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit", Udhëzimin nr.3 datë 18.07.2002 "Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësite e Qeverisjes Vendore" dhe VKM nr.500 datë 14.08.2001 "Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore"; Kërkesave numër protokolli 341 datë 13.02.2026 dhe numër 341/2 datë 24.03.2026 të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SH.A (OSSH) për "Kërkesë për vendimmarrje të Këshillit Bashkiak Tepelenë" për heqjen e të drejtës së përdorimit të Bashkisë Tepelenë të një pjese të pasurisë nr.3/1 ZK3574 me qëllim lënien në dispozicion për vazhdimin e procedurës nga OSSH për kalimin në administrim të OSSH në funksion të nënstacionit elektrik 110/10 kV Tepelenë.

**V E N D O S I:**

4. Bashkia Tepelenë ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.52 datë 24.12.2024 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tepelenë"; dhe Vendim të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr.60 datë 31.10.2024 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë",
5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr.12 datë 27.02.2019 "Për miratimin e lejeve të ndërtimit/zhvillimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)", në bashkitë të cilat kanë Plane të Përgjithshme Vendore të miratuara, autoritetet vendore te zhvillimit të territorit lejon dhënien e lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (D), për objektet e strukturat si më poshtë: a) Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial; b) Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sekstorial:

**PROPOZOJMË:**

Miratimin në parim të zhvillimit në sistemet bujqësore dhe natyrore sipas shprehjeve të interesit në tokat e dhëna me qira nga Bashkia Tepelenë dhe lejimin e dhënies së lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë Tepelenë për:

c) Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial;
d) Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sectorial.

Grupi i Punës:

1. Albion Tahmazi
2. Maksim Shehu
3. Gëzim Shehu
4. Avni Abedini

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I BASHKISË**
**TEPELENË**

Nr. 787/1 prot. Tepelenë më 22.04. 2026

**P/V E N D I M**

**Nr.____. Datë.___.___.2026**

**"Për miratimin në parim të zhvillimit të agroturizmit në sistemet bujqësore dhe natyrore sipas shprehjeve të interesit në tokat e dhëna me qira nga Bashkia Tepelenë".**

Në mbështetje tëLigjit 139/2015 "Për vetqeverisjen Vendore" të ndryshuar; nenit 8 "Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor"; Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit", të ndryshuar; Akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre; ligjin nr.57/2020 "Për pyjet"; ligjit Nr.9693, datë19.03.2007 "Për Fondin Kullosor" i ndryshuar; Nenit 801 në vijim të ligjit Nr.7850. date 29.07.1994, "Per Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimin Nr. 559, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve"; VKM Nr.467, datë 31.7.2025 " Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme"; Udhezimit te Ministrit te Mjedisit nr.1 date 9.6.2016 "Per rregullat e procedurat e kërkimit, shqyrtimit e te miratimit te kërkesave per dhënien ne përdorim te fondit pyjor e kullosor publik", si dhe VKM-se Nr. 433 date 08.06.2016 "Per Transferimin ne Pronesi te Bashkive të Pyjeve dhe të kullotave Publike" te ndryshuar; VKB nr.38 datë 29.03.2023 "Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor ndodhur në Bashkinë Tepelenë"; ligjit nr.8312 date 26.3.1998 "Per tokat bujqesore te pandara"; VKM 531 date 21.8.1998 "Per tokat bujqesore te pandara" te ndryshuar; dhe ligjit nr.9244 date 17.6.2004 "Per mbrojtjen e tokes bujqesore" të ndryshuar; Udhezimit nr.1 date 18.07.2012 "Per procedurat e dhenies me qira te tokave bujqesore"; VKB nr.39 date 29.03.2023 "Per miratimin e listes me siperfaqet e tokave bujqesore per tu dhene me qira nga Bashkia Tepelenë"; Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.52 datë 24.12.2024 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tepelenë"; Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr.60 datë 31.10.2024 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë"; Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.12 datë 27.02.2019 "Për miratimin e lejeve të ndërtimit/zhvillimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N):

**V E N D O S I:**

1. Miratimin në parim të zhvillimit në sistemet bujqësore dhe natyrore sipas shprehjeve të interesit në tokat e dhëna me qira nga Bashkia Tepelenë dhe lejimin e dhënies së lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë Tepelenë për:
   a) Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial;

b) Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial.

2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespodencës ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) dhe Drejtoria e Zhvillimit Rural (DZHR).
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër.

**Jurist**

**Julinda Karteri**

**Kryetar**

**Arben Gumeni**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

# V E N D I M

Nr. 52, datë 24.12.2024

## PËR
## MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR, BASHKIA TEPELENË

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë Nr. 60 datë 31.10.2024, "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë", me propozimin e Bashkisë Tepelenë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

## VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tepelenë, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:

   a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
   b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
   c) Rregullorja e Planit;
   d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
   e) Materiali hartografik:
      i. Vizioni strategjik;
      ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
      iii. Ndarja e territorit në njësi;
      iv. Përdorimi i propozuar i tokës;
      v. Infrastruktura e transportit;
      vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.

2. Në Zonat e Rëndësisë Kombëtare brenda territorit administrativ të Bashkisë Tepelenë, shpallur

si të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit apo me vendime të veçanta, autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara është Këshilli Kombëtar i Territorit.

3. Në Zonat e përcaktuara si të Rëndësisë Kombëtare dhe për Objektet e Rëndësisë Kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara te njësive të qeverisjes vendore, autoriteti përgjegjës për miratimin e Lejeve të Zhvillimit dhe Ndërtimit është Këshilli Kombëtar i Territorit.

4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, bashkia Tepelenë, duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.

5. Ngarkohet Bashkia Tepelenë për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentet e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Tepelenë .

7. Planet e Detajuara Vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.

8. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**ADELAJDA ROKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# KËSHILLI I MINISTRAVE
# KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

## VENDIM

Nr. 12, datë 27.02.2019

## PËR

## "MIRATIMIN E LEJEVE TË ZHVILLIMIT/ NDËRTIMIT NGA AUTORITETET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, NË NJËSITË QË I PËRKASIN SISTEMEVE URBAN (UB), BUJQËSOR (B) DHE NATYROR(N)"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", Vendimin Nr. 22, datë 12.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 283, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore", i ndryshuar dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli Kombëtar i Territorit,

## VENDOSI:

1. Në bashkitë të cilat kanë Plane të Përgjithshme Vendore të miratuara, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit lejohet të japin leje zhvillimi/ndërtimi, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N), për objektet e strukturat si më poshtë:

   a) *Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial;*
   b) *Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial.*

2. Ndërtimi i objekteve dhe strukturave, sipas pikës 1 të këtij Vendimi, duhet të respektojë legjislacionin në fuqi në fushën e bujqësisë, natyrës, mjedisit, pyjeve e kullotave, zonave të mbrojtura, etj. sipas territorit specifik.

3. Ndërtimi i objekteve dhe strukturave, sipas pikës 1 të këtij Vendimi, duhet të lejohet me kusht respektimin e kontekstit natyror/bujqësor dhe ruajtjen e peizazhit rural përkatës, si dhe moscënimin e infrastrukturës në funksion të tokës bujqësore (kanale kullues/vaditës, rrugë bujqësore, rezervuar, etj).

4. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në pasaportën e njësisë strukturore përkatëse, sipas dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, apo nga legjislacioni sektorial në fuqi, strukturat agroturistike nuk duhet të kalojnë lartësinë 2 kate me nënçati.

5. Riparimi, rinovimi, shtesat dhe përshtatja e strukturave ekzistuese të funksioneve të ndryshme, në struktura në funksion të agroturizmit është e lejuar me përmbushjen e përcaktimeve të këtij vendimi dhe në çdo rast duke respektuar legjislacionin sektorial në fuqi. Shtesat në strukturat ekzistuese duhet të jenë në respektim të pikës 4 të këtij vendimi.

6. Autoritetet e zhvillimit të territorit duhet të vijojnë me miratimin e kërkesave për leje zhvillimi/ ndërtimi për rastet sipas pikës 1 të këtij vendimi, vetëm pas:

   a. marrjes së konfirmimit nga Ministria e Linjës dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit;
   b. njoftimit të Këshilli Kombëtar të Territorit.

7. Pas ndërtimit të objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe strukturave të agroturizmit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të tyre në vijimësi.

8. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe autoritetet përgjegjëse të zhvillimit të territorit për zbatimin e këtij Vendimi.

9. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

**BLEDI ÇUÇI**

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

Nr...789.....prot.

Tepelenë më, 23.04.2026

# RELACION

## "PËR MIRATIM TË NIVELIT TË PAGAVE TË ADMINISTRATËS SË BASHKISË DHE STRUKTURAVE TË TJERA"

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja "b", nenit 54, shkronja"ç", nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015"Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr.152/2013, datë30.05.2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, nenit 6, shkronja "c" dhe nenit 9, të ligjit nr. 35/2023, datë 25.05.2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", **të ndryshuar**, vijmë me këto propozime :

QËLLIMI I PROJEKT VENDIMIT

Ky ndryshim vjen per keto arsye:

i. Ndryshime te nivelit te pagave sipas funksioneve dhe detyrave te ngarkuara te nepunesve civile ne Bashkine Tepelene dhe sistemimin e tyre. Ketu duhet te theksojme faktin kur nje nepunes kryen disa detyra .

ii. Unifikim te pagave dhe ne raport me te ardhurat qe gjeneron vete njesia Vendore . si qellim realizimin e indeksimit dhe rritjes se pagave per punonjesit e aparatit te Bashkise Tepelenw ne perputhje me legjislacionin per pagat.

iii. Zbatim të pikës 9 të VKM 328 /2023 me gjithë ndryshimet , për të kryer njehsimin e pagave të funksioneve që nuk janë përcaktuar në lidhjet e këtij vendimi.

ARGUMENTIMI I PROJEKT VENDIMIT lidhur me përparësitë, problematika , efektet e pritshme

**a.** në lidhjet n. nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7, , bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi., bëhen ndyshimet e shtesat si më poshtë:

Lidhja nr. 1 – Niveli i pagave në Njësitë Bashkiake me deri më 50 000 banorë

**Lidhja nr. 1 – Niveli i pagës për funksionarët dhe nëpunësit civilë në Bashkinë e Tepelenës**

| Kategoria | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 1 | — | Kryetar i Bashkisë | — | 246,000 |
| 2 | — | Zv/Kryetar i Bashkisë | — | 189,625 |
| I | I-5 | Sekretar i Përgjithshëm | 1 | 170,000 |
| II | II-2 | Drejtor Drejtorie | 1 | 144,525 |
| | II-2 | Sekretar i Këshillit Bashkiak | 1 | 144,525 |
| III | III-2 | Këshilltar i Kryetarit | 1 | 85,000 |
| | III-2 | Përgjegjës Sektori | 1 | 85,000 |
| | III-3 | Përgjegjës Sektori/zyre | 1 | 80,000 |
| IV | IV-3 | Specialist | 1/2 | 70,000 |
| | IV-4 | Specialist | 1/2/3 | 55,000 |
| | IV-4 | Sekretar i Kryetarit | 1/2/3 | 55,000 |

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 1 llogaritet mbi shtesën e pozicionit, në masën si vijon:
   - 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
   - 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
   - 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

2. Shtesa për kushte pune për Specialistët e IT, Përgjegjës Sektori i IT, Drejtor i Drejtorisë së IT, me diploma të arsimit të lartë ("Inxhinieri: elektronike, informatike, telekomunikacioni", "Informatikë" "Shkenca kompjuterike", "Teknologji informacioni", "Informatikë ekonomike", "Informatikë biznesi", "Inxhinieri matematike" dhe "Inxhinieri-matematike-informatike", përfitojnë një shtesë mbi pagë, në masën 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

**Lidhja nr. 2 – Niveli i pagës për punonjësit administrativ**

| Nr | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Paga bazë | Shtesa për vjetërsi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pika 11 | Magazinier, Punonjes arkive | 57,000 | 1% |
| 2 | Pika 10 | Shofer | 56,000 | 1% |
| 3 | Pika 10 | Pastrues | 50,000 | 1% |

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 2 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.
2. Shtesë për natyrë të veçantë pune për Lidhjen nr. 2, të jepet në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË

| Grupi i diplomës | Lloji i diplomës | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | **Diplomë e arsimit të lartë:** | |
| 1 | Master i Shkencave, Master i Arteve,<br>Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 14,000 |
| 2 | Master profesional<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 12,000 |
| 3 | Bachelor<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10,000 |

**Pagat e funksionarëve të zgjedhur**

Mbi bazën e Vendimit nr.103, date 11.02.2026 ·'Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328 datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Veteqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të Njesive të Veteqeverisjes Vendore" të ndryshuar, lidhja nr. I, e cila përcakton kufijtë e pagave për funksionarët e zgjedhur të organeve përf'aqësuesve dhe ekzekutive të njësive të veteqeverisjes vendore, paga mujore e kryetarit dhe nenkryetarit te Bashkise Tepelenë ndryshojne sipas tabelës

**Pagat e funksionarëve të kabineteve dhe nëpunësve civilë**

Paga bruto mujore e funksionareve të kabineteve si dhe nëpunësve civilë të njësive të veteqeverisjes vendore perbehet nga:

l) Paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të cdo pozicioni pune
2) Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës.
3) Shtesa për vjetërsi në punë
4) Shtesa për kushte pune (natyrë të vecantë pune).

**Paga per pozicion pune,** shperblen vleren relative te cdo pozicioni pune. Referuar lidhjes nr.6

te Vendimit nr.103 date 11.02.2026 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.328 date 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Veteqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të Njësive të Veteqeverisjes Vendore", i ndryshuar, paga për pozicion për cdo kategori sipas pozicioneve të punës që përmban struktura aktuale e Bashkise Tepelenë do ndryshoje sipas tabeles:

**Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (diploma),** që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës, referuar lidhjes nr.9 tw Vendimit tw Kwshillit tw Ministrave nr.503, datw 01.08.2024 është sipas tabelës së mëposhtëme:

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË

| Grupi i diplomës | Lloji i diplomës | Vlera |
|---|---|---|
| | **Diplomë e arsimit të lartë:** | |
| 1 | Master i Shkencave, Master i Arteve,<br>Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 14 000 lekë |
| 1 | Master profesional<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 12 000 lekë |
| 3 | Bachelor<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10 000 lekë |

"1. Shtesa për vjetërsi në punë për kategorinë I, jepet në masën:
a. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1 – 10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
b. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11 - 20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
c. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21 – 30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit."

Lidhja nr. 2 – Niveli i pagave në Njësitë ADMNISTRATIVE

| Emertimi | Kategoria | Grupi | Shtesa ne pozicion |
|---|---|---|---|
| Administrator qytet | L.8/3 | | 120,000 |
| Administrator qender | L8/3 | | 120,000 |
| Admnistrator Kurvelesh | L.8/4 | | 90,000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Admnistrator LOPES | L.8/4 | | 85,000 |
| Punonjes administrativë (administratorë shoqëror, protokoll, Z1N,) | IV-4 | 1ose2 ose 3 | 55,000 |
| Punonjes administrativë | Pika 11 | | 57.000 |

"1. Shtesa për vjetërsi në punë për kategorinë I, jepet në masën:
a. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1 – 10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
b. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11 - 20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
c. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21 – 30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit."

Lidhja nr. 3 – Niveli i pagave në Njësisne e Inspektimit te territorit ( Inspektoriati Vendor i mbrojtje së territorit **IVMT** - Polici Bashkiake **PB** )

| Pozicioni | Kategoria | Paga e grupit diplomës/ Grada | Vjetersia | Shtesa ne pozicion |
|---|---|---|---|---|
| **IVMT** | | | | |
| Krye Inspektor VMT | III-2 | 1 | | 90,000 |
| Inspektor VMT | IV-3 | 1 ose 2ose 3 | | 75,000 |
| **Kategoria II** | | | | |
| **P.BASHKIAKE** | | | | |
| Inspektor Polic Bashkiak | Pika 11 | | 1% | 60.000 |
| Polic Bashkiak | Pika 11 | | 1% | 55.000 |
| Punonjës shërbimi, Magazinier | Pika 11 | | 1% | 57.000 |

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 3, për kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

2. Shtesë për natyrë të veçantë pune për Lidhjen nr. 3, për kategorinë II, të jepet në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj.

**Punonjës me kohë të pjesshme** . *Ne zbatim te pika 1/b,kreu I "Mbrojtja dhe sigurimi i detyrueshem", pika 5, kreu III, "Llojet shuma dhe shperndarja e kontributeve" te VKM nr 114 date 30.07.2008, sigurimi i punetoreve te pastrimit, punonjesit e mirembajtjes do te behet ne nivelin e pages minimale.*

Lidhja nr.4 - **Niveli i pagave për punonjësit e " Drejtorisë së Shërbimeve Publike "**

| I | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | II-2 | Drejtor Drejtorie/ | 1 | 140,000 |
| | III-3 | Përgjegjës sektori (mirëmbajte,prodhimi,oficina) | 1,2 | 80,000 |
| | | | | |
| | IV-4 | Specialist | 1/2/3 | 55,000 |

| II | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Paga bazë | Shtesa për vështirësi | Shtesa për vjetërsi |
|---|---|---|---|---|---|
| | Pika 10 | Përgjegjës sektori (mirëmbajte,prodhimi,oficina) | 80,000 | | 1% |
| 1 | Pika 10 | Shofer për automjete speciale/teknologjike | 56,000 | | 1% |
| 2 | Pika 10 | Shofer për automjete mbi 2.5 tonë | 55,500 | | 1% |
| | Pika 10 | Shofer për automjete deri 2.5 tonë | 54,500 | | 1% |
| | | Punonjës të profesioneve të ndryshme (Hidraulik, Elektriçist, Kaldaist, Zhbllokues, Marangoz, Murator, Bojaxhi, Saldator) | 54,000 | | 1% |
| | Pika 10 | Punonjës Gjelbërimi, Pastrimi, etj | 50,000 | | 1% |
| | Pika 10 | Punonjës të shërbimit të varrimit( varrmihës) , grumbullimit të mbetjeve | 55,000 | 5% | 1% |

1. **Shtesa për vjetërsi në punë** në Lidhjen nr. 2, për kategorinë I, të jepet në masën si vijon:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit

2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 4, për kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

3. Shtesa për vështirësi për Lidhjen nr. 4, punonjës të shërbimit të varrimit dhe grumbullimit të mbetjeve , të jepet në masën 5%

4. Shtesë për natyrë të veçantë pune për Lidhjen nr. 4, për kategorinë: punonjës të shërbimit të varrimit dhe grumbullimit të mbetjeve, të jepet në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË

| Grupi i diplomës | Lloji i diplomës | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | **Diplomë e arsimit të lartë:** | |
| 1 | Master i Shkencave, Master i Arteve,<br>Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 14,000 |
| 2 | Master profesional<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 12,000 |
| 3 | Bachelor<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10,000 |

Lidhja nr. 5 – **Niveli i pagave për punonjësit e Drejtorisë së Arsimit ( Konvikt Çerdheve dhe Kopshteve)**

| I | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Grupi i diplomës | Paga për pozicion | Shtesa për vjetërsi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| | II-2 | Drejtor Drejtorie | 1 | 130,000 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| III | **III-3** | Përgjegjës sektori | 1 | 85,000 | |
| IV | **IV-3** | Specialist | 1/2/3 | 75,000 | |
| | | | | | |
| | | Drejtor i kopshtit me ushqim | 1 | 82,000 | |
| | | Drejtor i kopshtit pa ushqim | 1 | 77,000 | |
| | | Edukator kopshti e fëmijëve | 1/2/3/4 | 61,000 | |
| | | Edukator konvikti, kujdestar | 1/2/3/4 | 61,000 | |
| | **Pika 10** | Edukator çerdhe e fëmijëve | | 60,000 | 1 |

| **II** | **Klasa** | **Emërtesat e pozicioneve të punës** | **Paga bazë** | **Shtesa për vështrësi** | **Shtesa për vjetërsi** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **VI** | Kuzhinier | 55,500 | | 1% |
| 2 | **VI** | Furnitor, Magazinier | 55,000 | | 1% |
| | **III** | Ndihmës Kuzhinier | 54,000 | | 1% |
| | **II** | Roje | 50,000 | 2000 | 1% |
| | **I** | Sanitare , | 50,000 | 2000 | 1% |

1. **Shtesa për vjetërsi në punë në Lidhjen** nr. 5, për kategorinë I, të jepet në masën si vijon:

   - 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
   - 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
   - 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit

2. **Shtesa për vjetërsi në punë** për Lidhjen nr. 5, për kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË

| **Grupi i diplomës** | **Lloji i diplomës** | **Vlera** |
|---|---|---|
| **1** | **Diplomë e arsimit të lartë:** | |
| 1 | Master i Shkencave, Master i Arteve,<br>Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 14,000 |
| 2 | Master profesional<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 12,000 |

| | | |
|---|---|---|
| 3 | Bachelor<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10,000 |
| 4 | Diploma e arsimit të mesëm | 8,000 |

LIDHJA 6

**Niveli i pagave për punonjësit e Qendrës Kulturore të Fëmijëve dhe Qendrës Kulturore**

| I | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| III | | Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të fëmijëve dhe Qendrën Kulturore | 1 | 76,000 |
| IV | | Instruktor në Qendrën Kulturore të fëmijëve | 1 | 63,000 |

| II | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Paga bazë | Shtesa për vështirësi | Shtesa për vjetërsi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pika 10 | Telekronist, Magazinier | 55,000 | | 1% |
| 2 | Pika 10 | Pastrues, Roje, | 50,000 | 2000 | 1% |

1. **Shtesa për vjetërsi në punë në Lidhjen nr. 6,** për kategorinë I, të jepet në masën si vijon:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit

2. **Shtesa për vjetërsi në punë** për Lidhjen nr. 6, për kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

| Grupi i diplomës | Lloji i diplomës | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | **Diplomë e arsimit të lartë:** | |
| 1 | Master i Shkencave, Master i Arteve,<br>Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 14,000 |

| | | |
|---|---|---|
| 2 | Master profesional<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 12,000 |
| 3 | Bachelor<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10,000 |

**Lidhja Nr.7**

**Lidhja Nr. 8**

**Niveli i pagave për punonjësit e "Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit"**

| I | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Grupi i diplomës | Paga për pozicion | Shtesa për kushte pune |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| III | III-2 | Përgjegjës sektori | 1 | 90,000 | |
| | IV-3 | Specialist I | 1/2 | 75,000 | |

**1. Shtesa për vjetërsi në punë** në Lidhjen nr. 8, për kategorinë I, të jepet në masën si vijon:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË

| Grupi i diplomës | Lloji i diplomës | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | **Diplomë e arsimit të lartë:** | |
| 1 | Master i Shkencave, Master i Arteve,<br>Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 14,000 |
| 2 | Master profesional<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 12,000 |
| 3 | Bachelor<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10,000 |

**Lidhja nr. 9**

**Niveli i pagave për punonjësit e "Drejtoria e Zhvillimit Rural "**

| II | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Paga bazë | Shtesa për |
|---|---|---|---|---|

| | | | | vjetërsi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pika 10 | Roje pyje NJ.Administrative | 56,000 | 1% |
| 2 | | Pastrues | 53,000 | 1% |

**Niveli i pagave për punonjësit e "Zyra e Gjendjes Civile "**

| I | Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Grupi i diplomës | Paga për pozicion | Shtesa për kushte pune |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| III | IV-2 | Përgjegjës sektori | 1 | 85,000 | |
| | IV-3 | Specialist I | 1/2 | 65,000 | |

**1. Shtesa për vjetërsi në punë** në Lidhjen nr. 9, për kategorinë I, të jepet në masën si vijon:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË

| Grupi i diplomës | Lloji i diplomës | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | **Diplomë e arsimit të lartë:** | |
| 1 | Master i Shkencave, Master i Arteve,<br>Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 14,000 |
| 2 | Master profesional<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 12,000 |
| 3 | Bachelor<br>Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë | 10,000 |

Lidhja nr 10

SHPËRBLIMI PËR SEKRETARIATIN TEKNIK

| Emertesa e Bordit /sekretariati | Numri i pagesave në vit | Përbërja | | Masa e shperblimit në lekë | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Kryetari | Nr. Antarëve | Kryetari | Anëtari |
| Sekretariati teknik i Rregullimit të Territorit | 12 | 1 | 5 | 25000 | 2000 |
| | | | | | |

**VLERËSIMI I LIGJISHMËRISË**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja "b", nenit 54, shkronja"ç", nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015"Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr.152/2013, datë30.05.2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, nenit 6, shkronja "c" dhe nenit 9, të ligjit nr. 35/2023, datë 25.05.2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore",

**SQARIM PËR PROJEKT VENDIMIN**

**1.** Në këtë projekt vendimin, "Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Tepelenë", me vendime te veçanta për çdo pjesë të strukturës së Bashkisë Tepelenë.

2. Miratimin e shpërblimit mujor të antarëve të Këshillit të Bashkisë Tepelenë, në masën 10 % të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë.

3. Miratimin e shpërblimit mujor të 24 kryetarëve të fshatrave në masën 5% të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë.

4. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar të vitit 2026 dhe do të përballohen nga buxheti i miratuar i Aparatit të Bashkisë për vitin 2026.

**5.** Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Shërbimeve Organizative, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Menaxhimit Financiar , për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Dr. Juridik
Julinda KARTERI

Dr. Finances
Spiro KORA